


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7166
E enjte, 18 prill 2024
Çmimi 0.50

Asambleja Parlamentare
i thotë "po" anëtarësimit të
Kosovës në KiE, tash radha e
ministrave të jashtëm | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", PROF. DR. KUDUSI LAMA, GJENERAL NË PENSION

AKUZË DHE GJYKIM ME PARAGJYKIM PËR UÇK-në DHE LUFTËN E SËJ

FAQE 4-5

- Në Hagë po bëhet një lojë e shpifur. Ajo prokurori dhe ajo gjykatë kanë dështuar që në start, kur kanë ngritur akuza sipas thënieve të Prokurorisë së Përgjithshme të Serbisë



Gjenerali në pension, prof. dr. Kudusi Lama, ka vlerësuar se procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në Hagë ka kaluar përmasat e gjyqimeve mesjetare. Ai në këtë

intervistë për "Epokën e re" ka thënë se nëse Gjykatës Speciale do t'i bëhej një vlerësim i performancës, "do të fitonte të gjitha vlerësimet maksimale si gjykatë serbe që dënon shqiptarët". Lama ka thënë se që

të katërtit e UÇK-së do të duhej të ishin pranë familjeve të tyre. "Nuk dua të paragjykoj, por realisht më duket se ka një mobilizim të gjerë për të mos i lënë ata të kthehen në Kosovë...", ka thënë Lama

SERBIA HAKMERRET NDAJ VENDORIT TË KIE-s, I MBAN TË BLOKUAR NË KUFI QINDRA QYTETARË TË KOSOVËS F. 2



MINISTRI I JASHTËM I SHOIPËRISË TAKON THAÇIN NË HAGË: DO TË NGULIM KËMBË PËR NJË PROCES GJYQËSOR TË HAPUR E TRANSPARENT F. 7



MBROJTJA KËRKON QË PJETËR SHALA TË SHPALLET I PAFAJSHËM F. 6

"DËNIME NËN MINIMUM": DREJTËSI QË ZVARRITET, GRA QË VRITEN F. 7

FAHRI FAZLIUT TË RI SPECIALJA IA KONFISKON TELEFONIN F. 6

EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI TAKON PËRFAQËSUESIT E FMN-së, DISKUTOJNË PËR REFORMAT DHE ZHVILLIMET E ARDHSHE NË FUSHËN E STATISTIKAVE F. 8

AMBASADORI BRITANIK: DUA TË SHOH MË SHUMË BASHKËPUNIM NË FUSHËN E EKONOMISË F. 8

SPORT



SONTE VENDUSEN GJYSMEFINALISTËT NË LIGËN E EVROPËS F. 12

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mobi: +377 44 501289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NJË DITË PASI ASAMBLEJA PARLAMENTARE E KËSHILLIT TË EVROPËS VOTOI PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KËTË ORGANIZATË, SERBIA KA NDALUAR MË SHUMË SE 18 ORË NË KUFITARE TË UDHËTARË NGA KOSOVA, DUKE I MBAJTUR TË BLOKUAR

Serbia hakmerret ndaj vendimit të KiE-s, i mban të bllokuar në kufi qindra qytetarë të Kosovës

Autoritetet serbe kanë ndaluar të mërkurën autobusë me udhëtarë nga Kosova dhe vetura, në kufijtë me Kroacinë dhe Hungarinë, si shenjë hakmarrjeje ndaj mbështetjes nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka cilësuar si shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut ndalimin e qindra qytetarëve të Kosovës nga autoritetet kufitare në Serbi, duke theksuar se kjo është hakmarrje



interesuara për të adresuar çdo sfidë dhe pengesë për arritjen e këtyre qëllimeve”, thuhet tutje në reagim.

Edhe në të kaluarën, qytetarët të Kosovës që kalojnë përmes Serbisë kanë hasur në probleme, me disa prej tyre që janë arrestuar nga autoritetet serbe nën dyshimet për krime lufte.

Edhe shqiptarët e Luginës bllokohen në pikën kufitare të “Dheu i Bardhë”

Edhe deputeti shqiptar në Parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka reaguar ndaj bllokimit të shqiptarëve të Luginës së Preshevës në pikën kufitare të “Dheu i Bardhë”. “Mirë se vini në të ‘90-at. Serbia fillon me masa represioni ndaj shqiptarëve, menjëherë pasi që Parlamenti Evropian, ka rekomanduar anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës. Këto masa represive që po ndërmerren ndaj civilëve shqiptarë të Luginës së Preshevës, në vendkalimin kufitar ‘Dheu i Bardhë’, vijnë menjëherë pas vendimit të djeshëm të Parlamentit Evropian dhe kërcënimeve të para disa ditëve të presidentit serb Vuçiq për ‘procesimin e gjithë atyre që cenojnë rendin kushtetues’, ka shkruar Kamberi në “Facebook”.

Ai ka thënë se të rinjtë shqiptarë nga Bujanoci po ndalen sot në pikën kufitare të “Dheu i Bardhë” duke u mbajtur me orë dhe vonuar në këtë pikëkalim. “Kjo masë represive ndaj shqiptarëve të Luginës së Preshevës, po ndërmerret, krahas masave të njëjta që po ndërmerren ndaj shqiptarëve të Kosovës nëpër pikëkalimet kufitare serbe, sidomos, në kufirin me Kroacinë. Serbia, sot, po e shkelë brutalisht Marrëveshjen për tabelat e regjistrimit dhe po e cenon rëndë të drejtën fundamentale të njeriut ‘qarkullimin e lirë’. Këto masa po ndërmerren si masa retorive pas hapit të rëndësishëm të Republikës së Kosovës për anëtarësim në KE. Ndalesat nëpër kufij, patrullat policore dhe retorika e shfrenuar antishqiptare që po aplikohen ditët e fundit janë përsëritje e masave të agresionit të Serbisë ndaj shqiptarëve. Bashkimi Evropian dhe institucionet tjera ndërkombëtare duhet të dalin me reagim të fuqishëm ndaj represionit që po e ushtron shteti ‘pretendent për BE’”, ka shkruar Kamberi.

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 17 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka cilësuar “shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut ndalimin e qindra qytetarëve të Kosovës nga autoritetet kufitare në Serbi. Përmes një postimi në “X”, Kurti tha se qytetarët që kanë mbetur të bllokuar që nga mëngjesi në kufijtë e Serbisë me Kroacinë dhe Hungarinë, “janë privuar nga ushqimi dhe ilaçet”. “Një ditë pasi Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës votoi në favor të anëtarësimin të Kosovës në këtë organizatë, Serbia hakmerret kundër civilëve kosovarë. Që nga mëngjesi i sotëm, më shumë se 300 qytetarë - përfshirë fëmijë - janë ndaluar në mënyrë arbitrare në kufi, duke u privuar nga ushqimi dhe ilaçet. Shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut”, ka shkruar Kurti në “X”.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe ajo e Punëve të Brendshme e Kosovës më herët gjatë 17 prillit u bënë thirrje qytetarëve që me “çdo kusht” ta shmangin kalimin nëpër Serbi. MPJD tha se autobusë të Kosovës, me udhëtarë nga Kosova, janë bllokuar në dy pikëkalime kufitare të Serbisë me Kroacinë dhe në një pikëkalim kufitar me Hungarinë. “Qytetarët e Kosovës që po vinin në drejtim të Kosovës janë ndaluar edhe në kufirin me Hungarinë, në pikën kufitare në Suboticë, te vendkalimi kufitar Dheu i Bardhë [që lidh Kosovën me Serbinë] dhe nuk po lejohen as të lëvizin përpara dhe as të kthehen pas”, tha MPJD-ja. Kjo ministri tha se udhëtarëve u janë marrë dokumentet personale

si dhe ato të autobusëve. “Po ashtu, disa prej tyre janë marrë dhe po vazhdojnë të merren në pyetje”, u tha në njoftim.

Kjo ministri tha se këto veprime janë ndërmarrë në shenjë hakmarrjeje ndaj votës në Këshillin e Evropës një ditë më parë, po ashtu autoritetet serbe kishin paralajmëruar se do të arrestonin shtetas të Kosovës.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 14 prill paralajmëroi se çdokush që shkel rendin kushtetues të Republikës së Serbisë “do të arrestohet dhe ndiqet penalisht”. Ai bëri këto deklarata teksa foli për arrestimin e Sreçko Sofronijevićit nga autoritetet në Kosovë.

MPJD i është drejtuar faktorit ndërkombëtar për bllokimin e shtetasve të Kosovës në territorin serb, ndërkaq zëvendëskryeministri i Kosovës, njëherësh kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, po ashtu njoftoi se për situatën e ka njoftuar edhe ndërmjetësin evropian të dialogut, Mirosllav Lajçak. “Kjo është përgjigja e Serbisë dhe hipokrizia karshi respektimit të të drejtave të njeriut nga një shtet që aktualisht është anëtar i Këshillit të Evropës. Veprime të tilla edhe një herë dëshmojnë rënien e demokracisë dhe politikën e tyre të vazhdueshme të agresionit”, ka shkruar Bislimi në “X”.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës u kërkuan qytetarëve që të mos kalojnë përmes Serbisë “pas situatës së krijuar në pikat kufitare në Serbi dhe ndaljes arbitrare të qytetarëve të Kosovës në vendkalime kufitare”.

Bashkimi Evropian e ka vlerësuar shkelje të Marrëveshjes për Lirinë e Lëvizjes veprimin e autoriteteve të Serbisë, e cila ka bllokuar qytetarët kosovarë në kufijtë e saj, teksa i ka bërë thirrje Serbisë të përmbahet nga veprimet e tilla të njëanshme.

Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka thënë se janë duke e përcjellë nga afër situatën e krijuar. “Ne jemi të vetëdijshëm për situatën dhe e ndjekim nga afër. Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes e arritur në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja përcakton parametra të qartë për hyrjen dhe daljen e qytetarëve të Kosovës në dhe nga Serbia. Situata aktuale përbën shkelje të kësaj marrëveshjeje dhe ne i bëjmë thirrje Serbisë që të përmbahet nga veprime të tilla të njëanshme dhe të pakoordinuara dhe t’i kthehet menjëherë respektimit të marrëveshjes”, ka theksuar Stano. Ai tutje ka thënë se BE-ja pret që palët të zbatojnë plotësisht të gjitha detyrimet e tyre të dialogut, që sipas tij mbeten të vlefshme dhe detyruese. “Ne gjithashtu presim që palët të sigurojnë një mjedis të favorshëm për zhvillimin e dialogut dhe të shmangin çdo veprim që mund të rrezikojë sigurinë dhe stabilitetin”, ka theksuar tutje Stano. Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola Von Cramon ka reaguar pas maltremit të qytetarëve nga Kosova që është duke iu bërë Serbia në pikat kufitare.

Von Cramon përmes një postimi në “X” ka shkruar se Serbia duhet të ndalojë së turpëruari veten dhe menjëherë t’i lejoj qytetarët me pasaporta dhe letërnjoftim të Kosovës që të kalojnë kufirin e Batrovci! Duhet të sigurohet liria e lëvizjes së të gjithëve, pa diskriminim në bazë të kombësisë”, ka shkruar ajo.

Edhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka shprehur shqetësimin e saj të thellë lidhur me veprimet e fundit të ndërmarrja nga autoritetet serbe për të bllokuar lëvizjen e disa autobusëve që transportojnë njerëz nga Kosova për në Evropën Perëndimore.

Oda Amerikane thekson se kjo

bllokadë në vendkalimet kufitare ndërmjet Serbisë e Kroacisë dhe Serbisë e Hungarisë, paraqet shkelje të qartë të dispozitave të marrëveshjeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. “Marrëveshjet për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, synojnë promovimin e stabilitetit ndërmjet dy shteteve dhe gjithë rajonit. Në qendër të këtyre marrëveshjeve është parimi i lehtësimit të lëvizjes së lirë të njerëzve, i cili përbën një vlerë thelbësore në procesin e integritimit evropian. Duke penguar lëvizjen e qytetarëve të Kosovës në destinacionet e tyre të dëshiruara në Evropën Perëndimore, autoritetet serbe jo vetëm që po i minojnë këto marrëveshje por edhe po pengojnë përparimin drejt stabilitetit rajonal dhe integritimit evropian”, thuhet më tej.

Oda Amerikane beson fuqishëm se lëvizja e lirë e njerëzve është thelbësore për nxitjen e rritjes ekonomike, promovimin e shkëmbimit kulturor dhe forcimin e lidhjeve ndërmjet shteteve, prandaj kufizimet e tilla jo vetëm që pengojnë jetën e individëve, por kanë edhe ndikim negativ në tregtinë, investime dhe aktivitetet e biznesit në rajon. “Prandaj, Oda Amerikane i bën thirrje komunitetit ndërkombëtar që të kërkojë fuqishëm nga autoritetet serbe heqjen e menjëhershme të bllokadës dhe lejimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke mundësuar lëvizjen e tyre për në destinacionet e dëshiruara. Gjithashtu, ne u bëjmë thirrje autoriteteve të Serbisë që të përmbahen nga veprimet e ngjashme në të ardhmen duke respektuar angazhimet e tyre ndaj marrëveshjeve për normalizimin e marrëdhënieve. Si përfundim, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë mbetet e përkushtuar që të avokojë për parimet e lëvizjes së lirë, bashkëpunimit rajonal dhe prosperitetit ekonomik në Kosovë dhe në tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ne jemi të gatshëm të punojmë me të gjitha palët e



EPOKA ERE

Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Asambleja Parlamentare i thotë “po” anëtarësimit të Kosovës në KiE, tash radha e ministrave të jashtëm

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

STRASBURG, 17 PRILL - Shumica e deputetëve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës mbështeti të martën raportin që rekomandon anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë me seli në Strasburg. Për votuan 131 deputetë, kundër ishin 29, kurse 11 abstenuan. Asnjë nga amendamentet e propozuara nga Serbia nuk u miratua.

Çështja tashmë kalon në duart e ministrave të Jashtëm të Këshillit të Evropës, të cilët duhet të vendosin përfundimisht nëse Kosova do të bëhet anëtarja më e re e organizatës.

Krerët shtetërorë të Kosovës mirëpritën vendimin e Asamblesë Parlamentare, duke e cilësuar si dëshmi të përkushtimit të shtetit për demokraci. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, shprehu optimizëm për një vendim pozitiv në Këshillin e Ministrave në maj.

Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Ivica Dačić, tha se 16 prilli është “ditë e turpshme në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës”.


Këshilli i Evropës është një organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit në Evropë, me seli në Strasburg të Francës. Është themeluar më 1949.

Këshilli mbron lirinë e shprehjes dhe të medieve, barazinë dhe minoritetet në vendet anëtare.

Një prej përfitimeve direkte të qytetarëve të Kosovës nga anëtarësimi eventual në Këshillin e Evropës do të jetë qasja në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ].

Votimit i parapriu një debat që zgjati më shumë se dy orë. Shumica e deputetëve që morën fjalën e mbështetën anëtarësimin e Kosovës. Megjithatë, deputetët nga Franca thanë se do të ishte mirë që Kosova t'i bëjë hapat e parë drejt themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe para votimit final të ministrave në maj.

Serbia ka kundërshtuar anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Ky shtet kishte propozuar disa amendamente në tekstin për rekomandimin që Kosova të pranohet në këtë organizatë. Përmes tyre kërkohet që Kosova të mos pranohet në Këshillin e Evropës derisa Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara të mos vendosë për statusin e Kosovës. Serbia, po ashtu, kërkoi që në vazhdim të procesit, Kosovës t'i vihet si kusht themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Këto amendamente nuk kaluan. Autorja e raportit, Dora Bakoyannis, që është ish-ministre e Jashtme e Greqisë dhe motra e kryeministrit aktual



grek, Kyriakos Mitsotakis, në fillim të debatit tha se gjatë punës së saj asnjë “gur nuk ka mbetur pa u lëkundur” në përgatitjen e raportit dhe tha se është konfirmuar se, pavarësisht disa mangësive, Kosova është demokraci funksionale, duke i bërë thirrje Këshillit të Ministrave ta ftojë Kosovën të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës.

Bakoyannis shpjegoi se raporti nuk prek çështjen e njohjes apo mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës dhe se kjo çështje duhet të mbetet kompetencë e

shteteve.

Ajo ka përmendur hapat që ka bërë Kosova për t'i përmbushur kushtet, përfshirë edhe zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për pronësinë e Kishës Ortodokse Serbe në Deçan. Këtë e ka quajtur si “problemin më të madh në zbatimin e ligjit në Kosovë që ka pritur nga viti 2016”.

Duke folur për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, ajo tha se këtë e ka konsideruar si çështje krejtësisht në kompetenca të brendshme të Kosovës. Por, u

shpreh se ky ka qenë një gurtëmel në procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë që e udhëheq BE-ja. Prandaj, shtoi ajo, kjo çështje nuk është në duart e Këshillit të Evropës.

Bakoyannis, po ashtu, tha se ka kërkuar nga Kosova të sigurojë që shpronësimet e pronave të pakicës serbe të kryhen në respektimin më të rreptë të ligjit dhe se, në rast të pranimit të Kosovës, shpronësimi i paligjshëm i tokës do t'i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Ministri i Jashtëm i Shqipërisë takon Thaçin në Hagë: Do të ngulim këmbë për një proces gjyqësor të hapur e transparent

HAGË, 17 PRILL - Ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Igli Hasani, ka takuar të mërkurën ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi në Hagë. Ai pas vizitës ka dhënë detaje të takimit, duke theksuar se Thaçi ishte në gjendje të mirë shpirtërore, optimist dhe me besim të palëkundur. “Sot në Hagë u takova me presidentin Hashim Thaçi. E gjeta në gjendje të mirë shpirtërore, optimist dhe me besim të palëkundur që e drejta do të triumfojë. Ishte vërtet mbresëlënëse kuraja e tij, ekuilibri i brendshëm, qetësia e kthjelltësia e vizionit që ka për të ardhmen. I vetëdijshëm se proceset gjyqësore janë një maratonë me të përpjeta e tatëpjeta. Garën e fiton ai që është i përgatitur psikologjikisht. I përcolla zotit Thaçi urimet më të mira të drejtuesve më të lartë të qeverisë dhe të shtetit, të kryeministrit Edi Rama dhe kolegëve të tjerë, si dhe sigurinë që, ashtu si më parë, mbështetja jonë nuk do t'i mungojë në asnjë



rast dhe për asgjë”, ka thënë Hasani.

Ai ka theksuar se populli shqiptar nuk i harron as përpjekjet, as sakrificat e bijve të tij, ashtu si dje në luftë edhe sot në paqe. “E informova presidentin për zhvillimet më të fundit në vendin tonë, por edhe ato në rajon, si dhe përpjekjet e pakursyera nga ana jonë për paqen, stabilitetin dhe zhvillimin.

Diplomacia shqiptare, ashtu si dhe më parë, do të ngulë këmbë në zbatimin e standardeve për një proces gjyqësor të hapur e transparent, në respektim të plotë të të drejtave të njeriut sipas konventave ndërkombëtare. Një mbresë e pashlyeshme për mua si ministër i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë, por edhe si qytetar dhe admirues i përpjekjes së Hashim Thaçit dhe të gjithë atyre burrave që janë brenda në këtë gjykatë për lirinë e Kosovës”, ka deklaruar ministri i Jashtëm i Shqipërisë, Igli Hasani.



FLET PËR "EPOKËN E RE", PROF. DR. KUDUSI LAMA, GJENERAL NË PENSION

Akuzë dhe gjykim me paragjykim për UÇK-në dhe luftën e saj

- Në Hagë po bëhet një lojë e shpifur. Ajo prokurori dhe ajo gjykatë kanë dështuar që në start, kur kanë ngritur akuza sipas thënieve të Prokurorisë së Përgjithshme të Serbisë

Gjenerali në pension, prof. dr. Kudusi Lama, ka vlerësuar se procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në Hagë ka kaluar përmasat e gjykimeve mesjetare. Ai në këtë intervistë për "Epokën e re" ka thënë se nëse Gjykatës Speciale do t'i bëhej një vlerësim i performancës, "do të fitonte të gjitha vlerësimet maksimale si gjykatë serbe që dënon shqiptarët". Lama ka thënë se që të katërtit e UÇK-së do të duhej të ishin pranë familjeve të tyre. "Nuk dua të paragjykoj, por realisht më duket se ka një mobilizim të gjerë për të mos i lënë ata të kthehen në Kosovë...", ka thënë Lama

janë vrapues që marrin pjesë në garën e maratonës, por u diktohet të jenë të privuar nga liria dhe e drejta e takimit me njerëzit e tyre të dashur, jo më të thithin ajrin e pastër e të freskët siç e thithin maratonistët që marrin pjesë në garat e vrapimeve të gjata. Por kjo është vërtet një maratonë e një zvarritjeje të gjatë e të lodhshme për të gjithë shqiptarët që kanë pak ndjenjë kombëtare shqiptare, sepse ka një mobilizim për të na njollosur historinë, duke na i munduar një çetë burrash që na i mbajnë pengë vetëm se duan ta përkëdhelin kriminelin. E kriminali është ai që bëri të gjitha krimet mbi shqiptarët në Kosovë e më tej, por që duket se disa shqiptarë kanë harruar. Uroj të

mos u bjerë në kokë përsëri ajo që kaluam dhe ajo kundër së cilës luftuam dhe fituam. Është një gjyq ky që i ka kaluar përmasat e gjykimeve mesjetare. Është një gjyq ku ata që kanë interesa bëjnë si të fortë. Është një gjyq që bën përpjekje të bëjë drejtësi politike, por jo të gjejë të drejtën e të japë të drejtën atij që i takon. Është një gjyq që bën fajtorë burrat e gratë e Kosovës pse luftuan kundër Serbisë. Është një gjyq që kërkon llogari përse nuk i lamë serbët t'i vijonin masakrat mbi shqiptarët deri në zhdukjen e tyre. Është një gjyq ku dëshmitarë thiren

ata që edhe sot nuk përtojnë ta shprehin urrejtjen e pakufishme ndaj luftës çlirimtare dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Është një gjyq që për interesat e fuqive evropiane tregon se nuk ndien askush dhimbje nëse sakrifikohen ata që nuk duhet të sakrifikohen. Është një gjyq që botës po i jep masazhin se duhet t'i nënshtrohen masakrimin dhe robërisë, në të kundërt, nëse luftojnë për liri e çlirim nga pushtimi, do të ballafaqohen me akuza për krime lufte e krime kundër njerëzimit. Është një gjyq që u jep të drejtë pushtuesve të bëjnë çfarë të duan me vendet dhe popujt e pushtuar deri në shfarosjen e popujve autoktonë. Është një gjyq që përpigjet të justifikojë krimin duke akuzuar viktimën. Është një gjyq që nuk ndalet e nuk do të ndalet deri kur ta ndalin shqiptarët me forcën, e unitetin dhe me zërin e tyre përballë të gjithë atyre që po përpigjet të na kriminalizojnë luftën për liri dhe historinë më të lavdishme

kombëtare. Ky gjyq është modeli se si nuk mund e nuk duhet bërë drejtësi. Është modeli se si nuk mund të gjendet e drejta dhe e vërteta dhe se si nuk duhet të vihen njerëzit në bankën e të akuzuarit. Ky gjyq është modeli se si nuk duhet të punojnë institucionet e një shteti. Pasi kjo prokurori e Gjykatës Speciale siç quhet, se vërtet është speciale në llojin e vet, është një institucion që megjithëse është krijuar nga Kuvendi i Kosovës, është krijuar sipas ligjeve të Kosovës, thirret si institucion i Kosovës, vepron sipas ligjeve të Kosovës, por Kosovës, Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, presidentit të Kosovës dhe popullit të Kosovës nuk u jep llogari. As që do të dijë se ekziston Kosova. Ajo që i intereson këtij institucioni është vetëm thjeshtë të thirret në emër të tij. Nuk ka një tjetër rast në botë të krijuar ndonjëherë në histori që nga lashtësia e deri sot që të jetë i këtij modeli. Ky është modeli më i pakuptimtë dhe kundërligjor që ekziston në botë. Kur u kërkuar krijimi i këtij institucioni

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 17 PRILL -

"Epoka e re": Gjeneral Lama, më 3 prill është bërë një vit nga fillimi i procesit gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Si jeni duke e parë zhvillimin e këtij procesi maratonik? Gjeneral Lama: Mirë e keni shprehur "zhvillim i një procesi maratonik", se vërtet është një bredhje e gjatë dhe e lodhshme, një vijim i zgjatur dhe i pandërprerë i një veprimtarie të pakuptimtë. Vetëm me një ndryshim, se burrat shqiptarë të marrë peng në izolim në Hagë nuk

ishte rekomandimi se: meqenëse nuk mund të keni një prokurori e gjykatë të pavarur për këtë nivel gjykimesh siç janë krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, sepse prokurorët dhe gjyqtarët do të jenë nën presion dhe nuk do të mund të bëjnë drejtësi si duhet. Prandaj u tha: duhet të jetë një institucion drejtësie që të jetë i vendosur jashtë Kosovës dhe me prokurorë e gjykatës të vendeve të tjera jo të Kosovës, sepse kështu nuk do të jenë nën presion. Dhe Kosova meqenëse nuk i kishte askujt borxh, por të tjerët i kishin borxh, meqenëse nuk kishte bërë asgjë që binte ndesh me ligjet ndërkombëtare të luftës, pranoi ta krijonte këtë gjykatë. Por krijoi një gjykatë të sajën, jo një gjykatë të askujt e që thirret në emër të saj. Kurse po del se kemi krijuar një prokurori dhe një gjykatë shtesë për interesat e Serbisë. Dhe kjo vetëm se të fuqishmit nuk duan të shohin të drejtën dhe të vërtetën. Prej nga shihet se nuk mjafton vetëm e vërteta, por edhe forca njerëzore e qytetare e të fuqishmëve për të bërë që të fitojë e drejta.

Prandaj edhe për mua kjo gjykatë është një instrument presioni ndaj shqiptarëve për hatër të Serbisë e të Rusisë, për të treguar goja se jemi për baraspeshë të përgjegjësive. Megjithatë duhet thënë qartë se nuk është e drejtë të shtypemi ne për t'i rregulluar interesat e politikës e të mëdhenjve, se mjaft jemi shtypur e mjeruar.

Por kjo gjykatë që në themelimin e saj është rekomanduar nga "miqtë", me hile, kurse miqtë e vërtetë nuk e kanë marrë seriozisht. Dhe hilja qëndron pikërisht në fshirjen e krimeve serbe në Kosovë prej kompetencave të saj, për t'i hetuar e gjykuar; por krijimi i saj për të hetuar krime të supozuara të UÇK-së. Krime që nuk kanë adresë, por që montohen prej prokurorisë së këtij institucioni. Kurse që ende sot në Kosovë janë të zhdukur mbi 1 600 qytetarë shqiptarë të Kosovës nga Serbia as që i intereson dikujt të merret me këtë çështje. E me rëndësi është se dikujt i është dhënë një pëllëmbë nga dikush në kohën e luftës e tani duhet të japin llogari në gjyq për krime luftime për këtë pëllëmbë udhëheqësit e UÇK-së e të luftës së saj të lavdishme.

Dhe për të gjitha këto gjenden edhe dëshmitarë të montuar, sikur një shqiptar që shkruante se e mbaj mend mirë në verën e vitit 1998 kur Hashim Thaçi më ka kapur për krahu e më ka shtyrë. Deri këtu kemi arritur. Sikur nuk kishte punë tjetër Hashim Thaçi në verën e vitit 1998 vetëm të kapte për krahu e të shtynte tutje një kalbësirë. Jo. Në atë kohë Hashim Thaçi dhe bashkëluftëtarët e tij kishin punë të mëdha e të mençura për të bërë; kishin shumë punë trimërie e burërie për të bërë, nuk kishin kohë të merreshin me ata që vajtonin se po u ikën Serbia. Por ky është portreti i kësaj gjykate dhe këtë mall ka për tregun e seancave të saj.

"Epoka e re": E vlerësoni të padrejtë mbajtjen për gati katër vjet në paraburgim të liderëve të UÇK-së ndonëse disa herë kanë bërë kërkesë që të mbrohen në liri?

Gjeneral Lama: Unë e quaj të padrejtë që ata janë marrë atje, jo më që po mbahen prej katër vitesh në atë vend ndalimi, por as që ka dëshirë dikush ta marrë në konsideratë çfarë vlerësimi kam unë e çfarë vlerësimi kanë të gjithë shqiptarët që e duan sadopak atdheun e tyre. Megjithëse vlerësimi

që ata duhet të jenë pranë familjeve të tyre është më se normal. Duket se ata dikujt i prishin punë po të jenë në Kosovë. Nuk dua të paragjykoj, por realisht më duket se ka një mobilizim të gjerë për të mos i lënë ata të kthehen në Kosovë, qoftë të lirë duke marrë pafajësinë, qoftë duke vazhduar procesin gjyqësor siç ndiqen në gjithë botën duke qëndruar në liri e duke u paraqitur në gjykatë kur ka vijim të procesit gjyqësor. Ndërsa kërret e UÇK-së po rinë në izolim a thua se janë të rrezikshëm. Kur dihet se ata kanë shkuar në atë vendndalim veçse i kanë thirrur jo se i mori dikush me forcë. E ashtu ata do të kishin shkuar sa herë të thirreshin për ta vijuar ballafaqimin me akuzat.

Por, kërret e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë figura që nuk përsëriten. E ajo tufë burrash prej tyre që janë shpëputur e janë futur në izolim do të mbahen për të mbajtur nën kërcënim edhe të tjerët, që kanë mbetur të heshtur edhe mbështetësit e tyre që i mbajnë nën kërcënimin e arrestimit. Kjo që po ndodh në Kosovë me luftëtarët e UÇK-së është një dukuri e pa ndodhur në asnjë vend e luftë çlirimtare tjetër në botë. Vetë fakti që dy kryeprokurorë në këtë gjykatë, të cilët kanë mbledhur e montuar gjithçka për ta bërë të funksionojë këtë institucion, janë arratisur, është tregues i qartë i pathemelësisë së kësaj prokurorie e gjykate të thirrur në drejtësinë, por jo në të drejtën.

Ne u bëmë dëshmitarë që kryeprokurori i Dhomave të Specializuara, e quajtur Gjykata Speciale për krimet e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Hagë, i cili quhej Alex Whiting dhe që e kishte marrë këtë detyrë në nëntor të vitit 2022, duke zëvendësuar ish-kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale në Hagë, Jack Smithin, i cili u arratis nga Haga për arsytet që i di ai dhe shteti i tij, ShBA-ja, por që realisht la të kuptohet se u gjet mënyra që ai të largohet nga detyra, e që duket se shembullin e tij ndoqi edhe ky zëvendësues, me të njëjtat arsytetime.

Bën përshtypje fakti që për të hetuar ish-presidentin e ShBA-së, Donald Trump, u dashka që prokurorët të bëjnë një provë në Dhomat e Specializuara, të quajtura Gjykata Speciale për krimet e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Hagë. Përse kështu? A nuk paska ShBA-ja të tjerë prokurorë të aftë që të ndjekin e dënojnë presidentin Donald Trump, por duhet patjetër të gjenden të tillë që të bëjnë një provë në përmendje të luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

Kush është në gjendje të justifikojë të drejtën në këtë rast? Nuk mund të thuhet se aty gatuhet drejtësi sipas të drejtës. Aty gatuhet interesa që shkojnë prej Prishtinës, në Beograd, Bruksel, Moskë e deri në Nju-Jork e Uashington. Më vjen keq për ata burra që po vuajnë pa asnjë faj. Por jam krenar me ta dhe i lumtur që i kam njohur dhe e di cila është burrëria dhe qytetaria e tyre.

"Epoka e re": Kujt po i pengon që ata të mbrohen në liri pasi ata vullnetarisht janë paraqitur para Gjykatës Speciale duke qenë bashkëpunues në të gjitha fazat?

Gjeneral Lama: Çështja e mbajtjes së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në paraburgim siç thuhet, e realisht në izolim do të thosha unë, nuk është çështje e interesave të individëve.

Sepse askush nuk do të guxonte të ndërmerre hapa individualë për t'i mbajtur ata të mbyllur. Ky është një mekanizëm i ndërtuar ndërkombëtarisht për ta prerë në besë Kosovën dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. E ne shqiptarët si naivë që jemi kur mbështetemi në besën, të cilën shumë herë ua kemi dhënë atyre që nuk duhet, e përfituam edhe në këtë rast besëprejren e atyre që na e dhanë. Dhe këtë besë na e dhanë edhe ShBA-ja edhe Bashkimi Evropian e edhe OKB-ja. Por të gjithë sa na mashtroan harruan fjalën e dhënë dhe na përdorën për ta kënaqur Serbinë dhe klanin antishqiptar ndërkombëtar.

Serbia nuk e përmendë më çështjen e krimeve të luftës kundër serbëve në Kosovë, as çështjen e të ndaluarve në Hagë. Dhe mirë e ka. Këtë çështje e ka vënë në arkiv. Tani nxjerr çështje të tjera. Çdo ditë do të nxjerr një çështje të re. Serbia ka një plan. Ne jemi gjithnjë në rjetën e Serbisë. Dhe kjo vjen sepse nuk kemi një strategji të deklaruar të qëndrimit tonë, përtej së cilës nuk bëhen lëshime dhe nuk kemi një plan për ta bërë të qartë portretin e Serbisë siç e bëri Ushtria Çlirimtare e Kosovës në luftën çlirimtare e cila pikërisht, pse kishte një strategji të qartë, arriti të sjellë gjithë botën në luftë kundër Jugosllavisë e Serbisë në Kosovë, arriti ta bindë botën moderne për të drejtën e luftës së saj dhe për pastërtinë e asaj luftime.

Prandaj edhe kjo është një nga arsytet pse ata burra mbahen të izoluar. Sepse ata dinë të bëjnë strategji, dinë të bëjnë plane afatgjatë, dinë t'i tregojnë botës kush është Serbia dhe cila është fytyra e saj e përgjakur.

Ju thoni se ata luftëtarë në Hagë kanë qenë bashkëpunues gjithnjë. Keni të drejtë. Por bashkëpunimi që të quhet i tillë duhet të jetë i dyanshëm. E në rastin tonë këtu nuk ka bashkëpunim. Është Kosova me disa burra të saj në izolim dhe një institucion i Kosovës që ka dalë mbi Kosovën duke shkelur të gjitha ligjet që është duke bërë si e fortë se ka çelësa dhe mbyll dyert e burrave tanë atje për t'i mbajtur pengë.

Ka ardhur një kohë, që nëse ekziston një ligj i së drejtës ajo prokurori dhe ajo Gjykatë - të quajtura Speciale - duhet të hidhen në gjyq dhe duhet të futen në burg. Dhe kjo mbështetet në ligjin e së drejtës, nëse ekziston e drejta.

Ata burra që po mbahen atje në izolim, unë nuk e përjashtoj mundësinë që një ditë të gjenden në pozicionin e politikanit rus Aleksej Navalni në burgjet e Siberisë. Dhe të jeni të sigurt se askush nuk jep llogari nëse ndodh.

Nuk gjej asnjë arsye që ata burra mos të ndiqen në liri meqenëse kanë dëshirë t'i ndjekin. Por asaj gjykate askush nuk i bën të qartë hapësirat e të drejtave të saj. Ata i kanë dhënë vetes të drejtën të jenë mbi të gjithë.

Ajo gjykatë, nëse do të bëhej një vlerësim i performancës së saj, do të fitonte të gjitha vlerësimet maksimale si gjykatë serbe që dënon shqiptarët. Kush i njeh veprimtaritë e UDB-së, të prokurorisë e të gjykatës së Serbisë kundër shqiptarëve në kohën e sundimit të Milosheviqit, besoj e kupton se kjo prokurori e gjykatë speciale në Hagë nuk ka asnjë ndryshim prej tyre dhe po ndjek të njëjtën linjë, veçse gardianët nuk janë si ato të Serbisë se nuk i rrahin e torturojnë të ndaluarit apo të marrët pengë si në rastin e



burrave të Kosovës që janë mbyllur në Hagë.

"Epoka e re": Sipas jush, a ka dështuar Prokuroria të ofrojë ndonjë fakt inkriminues për katërshen e UÇK-së?

Gjeneral Lama: Në Hagë po bëhet një lojë e shpifur. Ajo prokurori dhe ajo gjykatë kanë dështuar që në start, kur kanë ngritur akuza sipas thëniesve të prokurorisë së përgjithshme të Serbisë. Ato kanë dështuar, që kur filluan të marrin dëshmitarë të fshehtë duke u bërë premtime e mashtime dhe duke i emërtuar me germa e numra sikur hebrenjtë në kampet naziste të shfarosjes.

Pra që këtu, duket se ky institucion ka marrë një përgjegjësi për të përmbushur detyra të parashkruara, jo detyra sipas të drejtës dhe të vërtetës.

Ndërsa mangësia jonë qëndron në faktin se ne kemi harruar atë thënie e famshme të Ciceronit se: "Pas fitores ke më shumë armiq". Nuk e kishim menduar se pas fitores dhe çlirimit të vendit nga pushtuesi gjakatar e masakruer i shqiptarëve armiq të do të lindnin edhe në Prishtinë për të plotësuar interesat e tyre të prishura e edhe në gjithë Evropën për të përkëdhelur Serbinë e Rusinë. Ne nuk u treguam në nivelin e duhur të vigjencës për të mos lënë që të gjallërohen armiq të luftës dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët duke bërë një luftë pa kompromis kundër luftës dhe UÇK-së, realisht po përpiqen të zhvillojnë ëndrën e tyre për kthimin e Kosovës nën Serbi, ëndërr që e shikon çdo ditë edhe Aleksandër Vuçiq.

E në këto kushte, Serbia ka të drejtë të jetë e lumtur dhe të jetë agresive, sepse shikon se ne duam të biem nën pushtetin e xhuxhëve, pasi siç ka thënë Uinston Çurçilli: "Kur lufta e gjigandëve mbaron, atëherë fillon lufta e xhuxhëve". Dhe tani të gjithë duhet ta dinë se kjo luftë po zhvillohet. Nuk është diçka e re. Por e re është që të merren peng udhëheqës të luftës së gjigandëve.

Kjo prokurori e gjykatë të quajtura speciale, të ngritura me ligjet e Kosovës, por që vepron kundër Kosovës, ka dështuar që në start, kur nuk donë të dëgjojnë për mbi 16 mijë të vrarët në Kosovë, prej të cilëve 14 mijë civilë të masakruar dhe nuk donë të dijë për rreth 1 600 të zhdukur që edhe sot e kësaj dite i kërkojnë familjet, por kërkon 300 serbë të supozuar se mund të jenë zhdukur nga UÇK-ja, por që nuk dihet cilët janë ata, si quhen ata, ku e kanë vendbanimin ata, cilat janë familjet e tyre etj. që këtu ky institucion i "drejtësisë" ka dalë nga shinat e qenies si i tillë.

Deri sot asgjë nuk është vërtetuar.

Dëshmitarët që u fshehin jo vetëm fytyrën, por edhe çfarë thonë ata, janë treguesi më i qartë se ata nuk kanë asnjë mundësi faktesh për të qenë transparent përpara qytetarëve të Kosovës.

Pa folur që ky institucion, në vend se të marrë përgjegjësi për të zbardhur se çfarë vërtetë ka ndodhur në periudhën e luftës Çlirimtare të Kosovës, duke i koordinuar veprimtaritë e të dy armiqve që janë ndeshur në atë luftë, merr në shqyrtim vetëm çfarë ka dëgjuar a i kanë thënë serbët për UÇK-në, a thua se ajo në Kosovë në vitet 1998 - 1999 ka luftuar me veten. Duket sikur në Kosovë në atë kohë nuk kanë qenë fare forcat serbe, por kanë qenë disa njësi të UÇK-së që kanë rrahë me shuplaka kë u ka dalë përpara. Prandaj këtij institucioni të "drejtësisë" i duhet bërë e qartë se në atë kohë në vitet 1998 - 1999 në Kosovë kanë qenë Forcat ushtarake, policore, paramilitare, kriminale e vullnetare, si dhe ato të mbrojtjes territoriale, që përbënin rreth 160 mijë luftëtarë me armë, të cilët patën dështime të njëpasnjëshme në luftimet përballë formacioneve të UÇK-së. Por ata duke treguar botërisht se janë forca që nuk zbatojnë asnjë ligj luftime, sa herë dështuan në luftimet përballë formacioneve të UÇK-së, i përdorën armët e tyre, pushkët, automatikët, mitralozat, topat, tanket dhe helikopterët e avionët gjuajtës bombardues, për të vrarë qytetarët në shtëpitë e tyre, për të vrarë shqiptarët nëpër rrugë, nëpër sheshe të qyteteve, për të shkatërruar shtëpitë e shqiptarëve e për të prishur gjithçka shqiptare. Këtë e kanë parë të gjithë. Por, për fat të keq, nuk e ka parë ky institucion i "drejtësisë" që vepron në emër të Kosovës, kundër Kosovës në Hagë.

Prandaj unë do të propozoj, se meqenëse Parlamentit të Kosovës i është dhënë e drejta që në vitin 2015, që të prodhojë gjykata speciale për krime luftime, e lus atë parlament të marrë mundimin të krijojë edhe një gjykatë tjetër për krime luftime, por tashmë për krimet e Serbisë e serbëve me të gjitha llojet e mjeteve kundër shqiptarëve të pa armatosur. E lus Parlamentin e Kosovës të prodhojë edhe një gjykatë të tillë se ia ka borxh Kosovës, meqenëse ka prodhuar të parën, atë që po mban peng një grup burrash luftime në Hagë. E kjo gjykatë e krijuar tani, të jenë të sigurt parlamentarët, qeveritarët, politikanët, qytetarët e edhe serbët, se do të jetë e suksesshme dhe do të ketë punë edhe për 50 vjet derisa t'i kryejë të gjitha çështjet që janë prezent në Kosovë dhe në Serbi të krimeve të kryera nga Serbia e serbët kundër shqiptarëve. **(Vijon)**

KQZ-ja: 33 shkolla refuzojnë mbajtjen e votimit në veri

PRISHTINË, 17 PRILL - Drejtorët e tridhjetë e tru shkollave në veri nuk kanë pranuar t'i japin për përdorim objektet shkollore për mbajtjen e votimit për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në

katër komunat me shumicë serbe në veri të vendit, ka thënë të mërkurën kreu i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Burim Ahmetaj. Ai ka theksuar se vetëm 10 shkolla

në të gjitha katër komunat në veri kanë thënë se mund të përdoren për procesin e votimit të muajit të ardhshëm. Votimi për shkarkimin e kryetarëve në katër komunat

në veri të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok, do të mbahet më 21 prill, duke u bazuar në një udhëzim administrativ të Qeverisë së Kosovës.



Fahri Fazliut të ri Specialja ia konfiskon telefonin

PRISHTINË, 17 PRILL - Fahri Fazliu i ri ka reaguar pas ndalimit nga EULEX-i me urdhër të Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Gjykatës Speciale. Ai u dërgua të mërkurën në zyrat e EULEX-it në Fushë-Kosovë dhe aty ia konfiskuan telefonin. Fazliu, i cili mban emrin e xhaxhait të tij, heroit të Kosovës, Fahri Fazliu, ka thënë se është ballëhapur dhe krenar me të kaluarën e familjes së tij dhe të popullit shqiptar. "Erërat lëkundin degët, por trungun jo". Të nderuar miq, shokë, dashamirë dhe kolegë! Sot, paradite rreth orës 8:00 të mëngjesit më ndodhi diçka shumë e çuditshme dhe e papritur përderisa isha duke e dërguar djalin tim Malin në kopsht, me dolën disa persona me thanë: Që jemi nga Prokuroria Speciale e Hagës dhe kemi një urdhër nga Gjykata Speciale e Hagës për konfiskimin e telefonit tuaj personal, pastaj më dërguan me veturën e tyre në zyrat e EULEX-it në Fushë-Kosovë dhe

aty më konfiskuan telefonin. Ballëhapur, kokëllart dhe gjithmonë krenar me të kaluarën tonë të lavdishme! Unë në luftë isha vetëm 8 vjeç", ka shkruar Fazliu në "Facebook". Ndaj kësaj ngjarje ka reaguar kryetari në detyrë i OVLUÇK-së, Faton Klinaku, i cili ka thënë se Gjykata ilegale Speciale, në mungesë të fakteve për krime luftime, vazhdon spektaklet e saj duke arrestuar edhe njerëz që në kohën e luftës së UÇK-së ishin fëmijë. "Ajo sot ka arrestuar Fahri Fazliun, nipin e heronjve Bahri e Fahri Fazliu, i cili gjatë luftës ishte vetëm 8-vjeçar. Krimin që po e bën ZPS, herëdokur do t'i kthehet bumerang vet asaj, dhe le ta kuptojnë njëherë e përgjithmonë se nuk mund të na nënshtrojnë as ata, ashtu siç nuk na ka nënshtroar as pushtuesi. Për sa kohë që do të zgjas kjo e keqe e madhe për Kosovën, do të kemi këso lloj spektaklesh", ka shkruar Klinaku në "Facebook".



Mbrojtja kërkon që Pjetër Shala të shpallet i pafajshëm



HAGË, 17 PRILL - Mbrojtja e Pjetër Shalës, e përfaqësuar nga avokati Jean-Louis Gilissen ka kërkuar që i akuzuari të shpallet i pafajshëm për krimet për të cilat akuzohet pranë Dhomave të Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë. "Në përfundim; ju kërkojë që të deklaroheni që pragu standardit ligjor të provave përtej dyshimit të arsyeshëm. Në rastin në fjalë nuk është përbushur dhe as nuk janë vërtetuar akuzat kundër të akuzuarit. Për pasojë, unë parashtojë që zotëri Shala duhet të shpal-

let i pafajshëm", tha avokati Gilissen. Ai tha se kërkon që të përdoren kriteret e duhura për të analizuar besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e të gjitha deklaratave që janë dhënë në këtë proces gjyqësor, raporton "Betimi për Drejtësi". "Ajo se çfarë po kërkojë unë dhe ajo se çfarë kërkohet prej ligjit dhe drejtësisë reale është që të përdoren kriteret e duhura për të analizuar besueshmërinë dhe mbështetshmërinë e deklaratave. Unë kërkojë që këto kriteret të jenë të njëjta për të gjithë. Të jenë të njëjta për

të gjithë, pavarësisht nëse deklaratat bëhen nga një i akuzuar apo nga një dëshmitar. Pra, kriteret duhet të jenë të njëjta për të gjithë", tha ai. Përpara kësaj, Gilissen tha se nuk e kontestojnë faktin që ka pasur të ndaluar të cilët janë keqtrajtuar në uzinën e metalit në Kukës, mirëpo ai tha se Pjetër Shala nuk ka marrë pjesë në veprime të tilla kriminale. "Kurrë, asnjëherë të vetme", tha Jean-Louis Gilissen, duke shtuar se ai nuk është fajtor as për vrasjen e njërit prej këtyre të ndaluarve.

ShKK-ja për tri vjet parandaloi 130 raste të kontrabandës në burgje

PRISHTINË, 17 PRILL - Drejtori i Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), Ismail Dibrani, ka thënë se në tri vitet e fundit janë shënuar 130 raste të parandalimit të kontrabandës në burgjet e Kosovës. Në konferencën me donatorët, Dibrani ka theksuar se këtë vit është shumëfishuar buxheti për investime kapitale, teksa shtoi se rrugët më të shpeshta të

kontrabandës në institucionet korrektuese janë përmes familjarëve apo kompanive të tjera të cilat furnizojnë institucionet me artikuj të ndryshëm. "Në raste të rralla ka pasur raste edhe kur stafi ka qenë i infiltruar por, fatkeqësisht, këta zyrtarë nuk janë më në pjesën e Shërbimit Korrektues e as nuk do të jenë asnjëherë. Si asnjëherë më parë ShKK-ja nga koha kur investime

kapitale kishim më pak se një milion euro, këtë vit po hyjmë me buxhet tetë milionë euro, gjë e cila na mundëson ndryshimin e infrastrukturës", ka deklaruar Dibrani. Më tutje, ai tha se ShKK-ja ka filluar projektimin dhe ndërtimin e institucioneve të reja ku, sipas tij, procesi i ndërtimit të burgjeve po bëhet në bashkëpunim me partnerë strategjikë dhe shoqërinë civile.



“Dënime nën minimum”: Drejtësi që zvarritet, gra që vriten

PRISHTINË, 17 PRILL - Dështimi i institucioneve të drejtësisë për të vepruar në mënyrë efektive po e përshkallëzon dhunën në familje - është vlerësim si i autoriteteve, ashtu edhe i organizatave që merren me të drejtat e grave.

Brenda pesë ditësh në Kosovë u vranë dy gra - e para në Ferizaj, më 12 prill, e dyta rreth 90 kilometra më larg, në Pejë, më 16 prill. Në të dyja rastet policia arrestoi burrat e tyre si të dyshuar kryesorë. “Burrat po mendojnë se kanë të drejtë të vendosin për jetën e grave, të vendosin se si dhe sa duhet të jetojë një grua”, tha Adelina Berisha nga Rrjeti i Grave të Kosovës për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas saj, mesazhe “trimëruese” dorasëve është duke u dërguar sistemi i drejtësisë në Kosovë me, siç thotë, “dënime të lehta”.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk iu përgjigj kërkesës së “Radios Evropa e Lirë” për të komentuar në këtë temë. As Gjykata Themelore në Prishtinë. Por, Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), i cili monitoron sistemin e drejtësisë në vend, konfirmon se rastet e vrasjes së grave “marrin dënime të ulëta, kthehen në rigjykim ose zvarriten”. “Një qasje e tillë tregon mungesë serioziteti dhe mungesë profesionalizmi në trajtimin e këtyre rasteve”, thotë Arrita Rezniciq, hulumtuese në IKD, për “Radion Evropa e Lirë”. Vrasja e rëndë në Kosovë dënohet me minimum 10 vjet burgim dhe me maksimum burgim të përjetshëm.

Rigjykim e zvogëlim dënimesh

Më pak se dy muaj më parë Gjykata e Apelit e Kosovës ktheu në rigjykim rastin e vrasjes së Marigona Osmanit, i cili prej avokatit të familjes së saj, Gazmend Rexhepi, ishte cilësuar si “më i rëndi në periudhën e pasluftës”.

Dardan Krivaqa u dënua me burgim të përjetshëm në gusht të vitit 2023 për vrasjen e 18-vjeçes në vitin 2021, ndërsa Arbër Sejdiu u dënua me 15 vjet burg për “ndihmë në kryerjen e vrasjes së rëndë”.

Gjashtë muaj më vonë, në shkurt të këtij viti, Gjykata e Apelit i miratoi ankesat e avokatëve të tyre mbrojtës për aktgjykimin. Ajo tha



se ka pasur shkelje procedurale gjatë gjyqimit dhe rastin e ktheu në rigjykim, ndërsa të akuzuarit mbetën në paraburgim.

Për avokatën Rexhepi, vendimi i Apelit “është joprofesional”. Derisa pritet të nisë rigjykimin, ai thotë se ky zhvillim “e ka rënduar gjendjen emocionale të familjes së viktimës”. Por, duke folur për “Radion Evropa e Lirë”, ai shpreh bindjen se burgimi i përjetshëm për Krivaqën, megjithatë, do të jetë “i pashmangshëm”. “Ekziston tashmë një ekspertizë e Institutit të Mjekësisë Ligjore, e cila konstaton se viktimat ka shumë thyerje dhe shumë lëndime... është vrasje shumë e rëndë. Nëse interpretohet juridikisht, i bie që vrasja e saj ka ndodhur në mënyrë mizore”, thotë Rexhepi.

Në Prishtinë u protestua më 28 shkurt kundër kthimit në rigjykim të rastit të Marigona Osmanit. Organizatat për të drejtat e grave ngenë zërin edhe për raste të tjera, si atë të Valbona Ndrecajt dhe vajzës së saj, të vrara në vitin 2018.

I dënua për vrasjen e tyre është bashkëshorti, përkatësisht babai Pjetër Ndrecaj, nga komuna e Gjakovës.

Ai, fillimisht, u dënua me burgim të përjetshëm, ndërsa më pas - pas ankesave të palës mbrojtëse - dënimi iu zvogëluar në 30 vjet burgim.

Berisha, nga Rrjeti i Grave të Kosovës, duke përmendur rastet Krivaqa dhe Ndrecaj, thotë se “me dënime të ulëta, me apelime, me

shtyrje dhe me vonesa të proceseve gjyqësore, jepet mesazhi se shoqëria jonë e toleron dhunën dhe vrasjen e grave”.

Në vitin 2021 IKD-ja publikoi një raport hulumtues për trajtimin e vrasjeve në përgjithësi në Kosovë, pa i ndarë në aspektin gjinor.

Rezniciq nga ky institut thotë se gjetjet e raportit flasin për një sërë dështimesh nga institucionet shtetërore, përfshirë edhe mungesën e kujdesit të duhur ndaj provave, të cilat duhet të përdoren në një procedurë penale. “Në këtë drejtim, në përgjithësi, trajtimi i rasteve të vrasjeve në Kosovë karakterizohet me mungesë të profesionalizmit nga ana e organeve të drejtësisë në ndjekjen dhe gjykimin e tyre”, thotë Rezniciq për “Radion Evropa e Lirë”.

Kritika edhe nga institucionet

Ministria e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, tha se dhunuesit, shpeshherë, “bëhen vrasës”, për shkak të “mosndëshkimit adekuat nga institucionet përkatëse”. “Kur dhunuesi e sheh që po ledhatohet nga sistemi, ai e përsërit veprën penale”, tha Haxhiu në një konferencë për medie të martën. “Kemi shumë raste kur dënime janë nën minimumin e asaj që parasheh Kodi Penal”, shtoi ajo. Kodi Penal i Kosovës parasheh

dënime me gjobë dhe deri në tre vjet burgim për të akuzuarit për dhunë në familje. Megjithatë, në një raport që publikoi Grupi për Studime Juridike dhe Politike në Kosovë, shtatorin e kaluar, thuhet se shumë pak të akuzuar për veprën e tillë janë dënuar me burg.

Raporti analizoi 129 aktgjykime të publikuara nga gjykatat e Kosovës dhe, sipas tij, 98 për qind të të akuzuarve për dhunë në familje iu shqiptua aktgjykim dënues, për shembull me gjobë, dhe vetëm 11 për qind u dënua me burgim.

Haxhiu tha se “është me rëndësi që të vendosen para përgjegjësisë disiplinore të gjithë gjyqtarët që nuk e respektojnë drejt ligjin”.

Ajo dha edhe disa propozime për, siç tha, luftimin e dhunës në familje - në mesin e tyre: “të bëhet urgjentisht nënshkrimi i kontratës për mbikëqyrje elektronike të dhunuesve, të bëhet saktë vlerësimi i sigurisë për çdo rast të dhunës në familje, të ashpërsohen dënime për armëmbajtje pa leje dhe të analizohet se si po sigurohen këto armë”.

Prokurori i krimeve të rënda në Prokurorinë Themelore në Pejë, Ersan Qavolli, tha se i dyshuari për vrasjen e gruas në këtë qytet, më 16 prill, “ka pasur një aktgjykim të veprës penale për dhunë në familje në vitin 2021”, por nuk dha më shumë detaje për rastin e tij. Të dhënat e Policisë së Kosovës tregojnë se, vitin e kaluar, janë raportuar 2.460 raste të dhunës në

familje, me viktimat kryesisht gratë.

Në raportin e datës 17 prill të Policisë së Kosovës thuhet se “në 24 orët e fundit, janë raportuar 11 raste të dhunës në familje” dhe se në të gjitha rastet, burrat janë raportuar si dhunues.

Por, sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile, numri i grave që përjetojnë dhunë në familje, është shumë më i lartë se shifrat zyrtare. Ata thonë se dhuna nuk raportohet për disa arsye, përfshirë: presionin social mbi gratë, mungesën e pavarësisë së tyre ekonomike dhe mostrashëgimin e pasurisë nga prindërit.

Vendimet për raste të tjera të vrasjes së grave

Të dhënat nga Policia e Kosovës dhe Rrjeti i Grave të Kosovës tregojnë se nga viti 2010 deri në prill të vitit 2024, në Kosovë u vranë 57 gra. Në shumicën e rasteve, autorë të vrasjeve ishin bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

Rasti i fundit - para rasteve në Ferizaj dhe Pejë këtë muaj - ndodhi më 29 nëntor të vitit të kaluar në Prishtinë, ku u vra Liridona Murseli.

Tre të dyshuarit për këtë vrasje, në mesin e tyre edhe bashkëshorti Naim Murseli, ndodhen ende në paraburgim, pa ndonjë aktakuzë. Gjykata Themelore në Prishtinë ua vazhdoi masën e paraburgimit në fund të shkurtit dhe ajo do t’iu llogaritet deri më 28 prill.

Nga të tjera raste, Nuhi Mavrovqani u shpall fajtor për vrasjen e gruas së tij, Sabile Mavrovqani, në vitin 2020 në komunën e Kamenicës. Pas dënimit fillestar me burgim të përjetshëm, rasti u kthye në rigjykim në Gjykatën Themelore të Gjilanit dhe ai u dënua me 25 vjet burgim.

Bajram Velija u dënua, gjithashtu, me burgim të përjetshëm për vrasjen e gruas së tij, Armenda Aliu, në Prizren, në vitin 2019. Por, pas ankesës së palës mbrojtëse, Gjykata e Apelit i shqiptoi dënimin prej 25 vjetësh burgim.

Në prill të vitit të kaluar, ndërkaq, i akuzuari për vrasjen e Donjeta Pajazitajt më 2015, kushëriiri i saj, Naser Pajazitaj, u lirua nga akuzat për vrasje dhe nga burgju, me vendim të Gjykatës Supreme.

I ashpërsohet dënimi burrit që vrau gruan me sëpatë në Prishtinë

PRISHTINË, 17 PRILL - Gjykata Themelore në Prishtinë në rigjykim ka dënua me 35 vjet burgim I. G. për vrasjen e gruas së vet më 2022 në Prishtinë.

I. G., në gjykimin e parë, në qershor të vitit 2023, nga Gjykata Themelore në Prishtinë ishte dënua me 25 vjet burgim për vrasje të rëndë. Vrasja e rëndë në Kosovë dënohet me minimum 10 vjet

burgim dhe me maksimum burgim të përjetshëm.

Më 29 nëntor të vitit 2022, në orën 04:00, në shtëpinë të tij në Prishtinë, I. G. kishte privuar nga jeta bashkëshorten. Sipas gjykatës, ai kishte vepruar “në mënyrë mizore dhe dinake”, duke e goditur disa herë me sëpatë viktimën S. G., e cila në kohën e sulmit ishte duke fjetur në shtrat.

Gjykata tha se viktimat, 63 vjeçe, ishte goditur disa herë me sëpatë në pjesën e majtë të kokës “duke i shkakuar asaj lëndime të rrezikshme për jetën, e për shkak të cilave e ndjera kishte ndërruar jetën”.

Të dënuarit do t’i llogaritet koha e qëndruar në paraburgim, ku do të qëndrojë deri në plotfuqishmërinë e aktgjyqimit.



Parandalohen katër raste të kontrabandës së mallrave nga Serbia në Kosovë

MITROVICË, 17 PRILL - Njësitë e Antikontrabandës së Doganës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, kanë arritur të ndalojnë katër raste të kontrabandës së mallrave nga Serbia në Kosovë duke shfrytëzuar rrugët dytësore. Në këto raste të suksesshme të parandalimit të kontrabandës janë sekuestruar këto mallra. "Rasti 1: Mallra ushqimore në peshë 220 kg me vlerë prej 1,400.00 euro. Rasti 2: Mallra ushqimore dhe pije të ndryshme në sasi prej 1,530.7

kg me vlerë prej 2,400.00 euro. Rasti 3: Çokollata në peshë 266 kg me vlerë prej 1,700.00 euro. Rasti 4: Pije alkoolike dhe cigare (60 litra dhe 7640 cope cigare) me vlerë prej 1,300.00 euro. Këto operacione të suksesshëm janë rezultat i angazhimit dhe tregon përkushtimin e autoriteteve për luftën ndaj kontrabandës. Njësitë Doganës dhe Policisë së Kosovës vazhdojnë të punojnë në mënyrë të palodhshme për të mbrojtur

interesat e shtetit dhe të qytetarëve nga veprimtaria e paligjshme dhe të dëmshme për shoqërinë", është bërë me dije në njoftimin e Doganës. Dogana e Kosovës ka aplikacionin eDogana për pajisjet e mençura android dhe ios, i cili mundëson lajmërim të parregullsisve dhe sjelljeve joprofesionale me komunikim të sigurt dhe ofron shërbime të tjera me qëllim të shërbimit ndaj qytetarëve dhe komunitetit të prodhuesve dhe tregtisë në përgjithësi.



Guvernatori Ismaili takon përfaqësuesit e FMN-së, diskutojnë për reformat dhe zhvillimet e ardhshme në fushën e statistikave

PRISHTINË, 17 PRILL - Në kuadër të takimeve pranverore në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) që po mbahen në Uashington, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, zhvilloi takim me drejtorin e Departamentit të Statistikave, njëherësh kryestatistikant i FMN-së, Bert Kroese, bashkë me ekipin e tij. Në takim u diskutua për reformat dhe zhvillimet e ardhshme në fushën e statistikave, në funksion të avancimit të përgatitjes së të dhënave, rritjes së transparencës dhe informimit më të qartë të publikut. Gjatë takimit u diskutua më konkretisht për avancimin e raportimit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës nga Sistemi i Përgjithshëm i Shpërndarjes së të Dhënave (GDDS) në Standardin e Veçantë të Shpërndarjes së të

Dhënave (SDDS) dhe ngritjen e kapaciteteve të BQK-së në këtë fushë, avancimin e ndërtimit të Indeksit për Llogaritjen e Çmimeve të Patundshmërive (IÇPB), mundësinë e ndërtimit të një modeli për matjen e parasë së gatshme në qarkullim dhe avancimin e përpilimit të llogarive kombëtare. Gjithashtu, është biseduar për avancimin e metodologjive për statistikën financiare qeveritare dhe bashkërendimit ndërinstitucional në funksion të përmirësimit të kualitetit të të dhënave. U theksua avancimi i reformave në këto fusha do të ndikim në politikëbërjen ekonomike, vlerësimin e aseteve, parandalimin e pastrimit të parave, mbikëqyrjen më efikase të institucioneve financiare, të gjitha këto në funksion të stabilitetit financiar dhe ekonomik të Republikës së Kosovës. Guvernatori Ismaili shprehu



mirënjohjen ndaj FMN-së për asistencën e vazhdueshme ndaj BQK-së dhe i njoftoi drejtuesit e lartë të këtij institucioni për reformat e ndërmarra nga institucioni që e drejton dhe gatishmërinë për

bashkëpunim të ngushtë si në fushën e statistikave, po ashtu edhe në sferat e tjera me rëndësi në kuadër të fushëveprimit të BQK-së. Në kuadër të takimit është konfirmuar se mbështetja e FMN-së

për BQK-në do të vazhdojë edhe në të ardhmen në funksion të ngritjes së kapaciteteve dhe reformave të zhvillimit në fushën e statistikave, si një rëndësi e veçantë për informimin e drejtë dhe transparent të qytetarëve.

Shqyrtohet raporti i auditimit të performancës "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës"



PRISHTINË, 17 PRILL - Mbledhja e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës të kryesuar nga kryetarja e komisionit, Hykmete Bajrami. Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i auditimit të performancës "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes së tyre në tregun e punës". U theksua se ministri i Bujqësisë nuk do të jetë në këtë

takim për shkak të disa agjendave të tjera, ndërsa sqarimet e nevojshme për këtë i dha drejtoresha e Agjencisë së Punësimit, Jehona Rexha, si dhe përfaqësues të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Fillimisht, në cilësinë e deputetes raportuese këtë raport e paraqiti anëtarja e Komisionit, Albana Bytyqi. Ajo duke paraqitur të dhëna nga auditivi, tha se si e gjetur është evidentuar edhe fakti

se ende nuk është arritur rezultat i kënaqshëm me pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, me theks të veçantë në zonat rurale. Sipas Bytyqit, kriteret e përzgjedhjes nuk sigurojnë barazi në përzgjedhje. Gjatë këtij takimi kritika pati edhe rreth kushtëzimit të pronësisë, duke u vënë në pah fakti se grave nuk u është ofruar procedurë më e lehtë për t'u kyçur në këtë çështje.

Ambasadori britanik: Dua të shoh më shumë bashkëpunim në fushën e ekonomisë

PRISHTINË, 17 PRILL - Ambasadori i ri i Britanisë së Madhe në Kosovë, Jonathan Hargreaves, ka folur për bashkëpunimin në mes të Britanisë dhe Kosovës, në veçanti në fushën e ekonomisë. "Unë do të doja të shihja më shumë bashkëpunim ekonomik. Para se të vijë këtu takova disa njerëz të mirë në diasporën e

Kosovës në Mbretërinë e Bashkuar si dhe kompani të cilat janë të përkushtuara të bëjnë biznes këtu", ka deklaruar ambasadori britanik në një intervistë për "Telegrafi"-n. Sipas tij, ka shumë potencial dhe shumë vullnet të mirë mes dy vendeve për bashkëpunim. "Ka potencial për investime të konsiderueshme, të

mbështetura nga oferta e konsiderueshme e Financave të Eksportit të Mbretërisë së Bashkuar për rajonin me Kosovën - në pozitë të mirë për të qenë një qendër rajonale për disa sektorë. Unë e shoh këtë si një nga mënyrat më të mira për të thelluar dhe mbajtur marrëdhëniet midis vendeve tona në të ardhmen", ka thënë ambasadori Hargreaves.



Hija e Pekinit



Ekziston një fije e përbashkët që lidh luftën në Ukrainë, konfliktin izraelito-palestinez dhe sulmin e Iranit ndaj Jeruzalemit. Një “emërues më i vogët i përbashkët”, që mund të përkufizohet si një përpjekje për të dobësuar Perëndimin. Idealet, vlerat dhe ekonominë e tij.

Këto janë efekte që fillimisht mund të konsiderohen anësore, por që bëhen kryesore në një fazë të mëvonshme. Nëse shikon kontekstin global. Sidomos nëse vëzhgojmë sesi Kina, antagonistja e vërtetë globale e SHBA-së dhe e Perëndimit në mijëvjeçarin e tretë, po shfrytëzon krizat e ndryshme të luftërave.

Izraeli është “pararoja” perëndimore në Lindjen e Mesme. Kështu gjykohet edhe nga të gjitha vendet në atë zonë. Sidomos nga armiqet e tij. Nga ky aspekt lindin edhe përgjegjësi. Shumë të tilla. Për aleatët e tij, por edhe për qeverinë. Një luftë rajonale apo edhe më e gjerë do të prodhonte në mënyrë të pashmangshme pasojë në shkallë të gjerë.

Nisja e një përplasjeje me Teheranin nuk përbën një

angazhim gjigant vetëm për izraelitët dhe për ekzekutivin e udhëhequr nga Netanyahu, por për të gjithë botën perëndimore. Edhe në aspektin ekzistencial. Opsionet e vlerësuar nga Jeruzalemi nuk kanë pasojë vetëm në Tokën e Shenjtë. Presioni i nisur nga Uashingtoni dhe Brukseli ka pikërisht këtë objektiv: të bëjë të qartë se në një botë të ndërlidhur, edhe lufta është e globalizuar. Se Perëndimi mund të dobësohet. Dhe kështu, numri i sistemeve jodemokratike mund të rritet më tej.

Mjafton të shikosh atë që po ndodh tani. Vëmendja, burimet, përqendrimi tek Izraeli përcakton pavëmendjen, privimin dhe largimin e vëmendjes nga Ukraina. Dhe si pasojë sjell një fuqizim të Rusisë, e cila në mënyrë të qartë po përfiton nga agresioni iranian për të rritur presionin ndaj Kievit, si dhe për të rifituar rolin e saj në botë, që e kishte humbur gjatë tridhjetë viteve të fundit.

Shqetësimi i Bashkimit Evropian, SHBA dhe G7-ës, të cilët po përgatiten të konfirmojnë në Jeruzalem kërkesën për të moderuar reagimin ndaj

Teheranit, është në thelb ky. Regjimi i Ajatollahëve ka përsëritur zgjedhjen e tij të animit nga Moska dhe Pekini. Nuk mund të injorohet. Nuk mund të anashkalohet as që historia e 110 viteve të fundit na ka mësuar se luftërat botërore janë shkaktuar nga një fitil i vendosur në Evropën Lindore: në Sarajevë dhe në Sudetenland.

Prandaj është Kina ajo që do të korrë fitimet më të mëdha nga kjo situatë. Në mënyrë paradoksale, ajo mbështet Moskën, e cila synon të rivendosë ekuilibrin e Jaltës, me qëllim përmbysjen e sferave të influencës, të krijuara pothuajse tetëdhjetë vjet më parë. Dhe e bën në mënyrë të saj. Nga të gjitha konfliktet që po ndodhin tani, trupat e Kinës nuk janë të pranishme në asnjë. Ato janë vëzhgues të interesuar. Dhe me avantazhe. Nuk humbin forcën, nuk përdorin para, nuk rrezikojnë imazhin e tyre me vendet ndërluftuese dhe shfrytëzojnë dobësitë e të tjerëve. Ata futen në të çarat më kritike, për t'i zgjeruar ato dhe për të hyrë në konkurrencën globale me Perëndimin, pa u rënduar. Pa asnjë lloj ngarkese. Thjesht

shfrytëzojnë dobësitë nga jashtë. Dhe e bëjnë në një kohë dobësi “demokratike” të sistemit perëndimor. Demokracitë tona, të para nga regjimet autoritare dhe autokratike, kanë një pengesë të bezdisshme: zgjedhjet. Bashkimi Evropian do të përballet me to në qershor, Shtetet e Bashkuara në nëntor. Deri atëherë rreziku kryesor është paraliza. Pamundësia për të marrë vendime të forta. Në Amerikë, mbi të gjitha, fushata elektorale e Donald Trumpit përfaqëson një faktor të mëtejshëm dobësues. Dy ditë më parë, ish-presidenti amerikan dha një shpjegim për sulmin iranian, i cili vetëm sa e përkeqëson situatën dhe nxit krizën: “Ne jemi treguar të dobët”. Megjithatë, linja e Bidenit, edhe me rastin e mbrojtjes që i ofroi Izraelit, u mbështet gjerësisht dhe ai mundi të llogariste një një element që nuk ishte aspak i dukshëm: mbështetjen e botës sunite.

Prandaj Shtëpia e Bardhë po i kujton qeverisë izraelite se pa ndihmën e saj, si dhe atë të Britanisë së Madhe dhe Francës, mburoja e raketave vështirë se do

të ishte aq efikase sa dy ditë më parë. Por më shumë se një paralajmërim, është një kërkesë, nga ata që shohin rreziqet e një konflikti të madh. Në të cilin, në rrezik nuk është vetëm fitorja apo disfata ushtarake, por ruajtja e atij sistemi vlerash dhe idealesh që ne e kemi quajtur Perëndim, për njëqind vjet.

Me këto rreziqe po përballet edhe Evropa. Dhe me të gjitha vështirësitë e veta. Në ditët në vijim ajo do të përpiqet të vendosë sanksione të reja kundër Teheranit (por vetëm personale dhe jo kundër shtetit), duke shmangur kompromentimin e dialogut. E vetëdijshme se aftësia e saj për ndërmjetësim është zvogëluar. Megjithatë, vitet e ardhshme do të jenë kritike për të ardhmen e BE-së. Dhe struktura e saj institucionale, në këtë kontekst shumë dramatik, nuk mund të jetë e zakonshme. Zgjedhjet e bëra tani do të rëndojnë mbi perspektivat e Bashkimit si kurrë më parë. Prania apo jo e liderëve të aftë për t'u përballur me këtë lloj krize, do të bëjë ndryshimin midis përparimit ose regresit. / La Repubblica – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sonte vendosen gjysmefinalistët në Ligën e Evropës



“Epoka e re”

ROMË, 17 PRILL - Në çerekfinalët e Ligës së Evropës zhvillohet përballje mes dy skuadra italiane, Romës dhe Milanit, në “Stadio Olimpico” të enjten në mbrëmje, pasi kuqezinjtë fituan me një epërsi të vogël nga ndeshja e parë që u zhvillua në javën e kaluar. Milani ka fituar dy ndeshje në Serinë A këtë sezon, por sukcesi 1-0 i Romës e bën më afër kualifikimit dhe përballjes me fituesin e ndeshjes në mes të West Ham Unitedit ose kampionët e rinj gjermanë Bayer Leverkusën në gjysmëfinale.

Trajneri i Romës, Daniele De Rossi, ka thënë se kjo ndeshje është shumë e rëndësishme për fatin e sezonit,

LIGA E EVROPËS		
21:00 Atalanta - Liverpool	(3-0)	
21:00 Marseille - Benfica	(1-2)	
21:00 Roma - Milan	(1-0)	
21:00 West Ham - Bayer Leverkusen	(0-2)	

pasi triumfi në Ligën e Evropës siguron një vend në Ligën e Kampionëve. “Luhet një ndeshje përcaktuese për fatin e sezonit, shumë e rëndësishme, pasi Liga e Evropës është një objektivi i skuadrës. Është një mundësi e shkëlqyer për të siguruar edhe një biletë për në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm. Ne jemi të vetëdijshëm se për të kaluar për më tej duhet të fitojmë me çdo kusht, në të kundërtën do të jemi jashtë. Ne do të bëjmë lojën tonë, do

të përpiqemi të mbrohemi mirë, por dhe t'i bëjmë keq Milanit. Nëse do t'i shënojmë një gol, për të do të ishte një goditje e fortë”, ka thënë De Rossi. Një tjetër ndeshje interesante do të zhvillohet në Angli aty ku West Ham Unitedi e pret Bayer Leverkusën që e fitoi ndeshjen e parë me rezultat 2-0. Nuk do të jetë aspak lehtë për anglezët ta përmbysin epërsinë e skuadrës gjermane që ditë më parë e festoi edhe titullin historik në Bundesliga. Rezultat i ngushtë është mes Marseilles dhe Benficës (1-2). Të dyja skuadrat do ta synojnë kalimin në gjysmëfinale. Mision të vështirë dhe thajse të pamundur ka skuadra e Liverpoolit në përballje me Atalantën. “Reds” ka pësuar humbje 0-3 si vendas dhe tash në Itali do të jetë ndeshje e zjarrtë.

SHKURT

Arrestohet Akil Gjakova, dërgohet në mbajtje

Policia e Kosovës ka njoftuar se e ka arrestuar xhudistin kosovar Akil Gjakova. Ylli i sportit kosovar ishte duke qëndruar jashtë vendit tash e sa ditë, ndërsa në orët e vona të mbrëmjes është futur në territorin e Kosovës dhe është dorëzuar në polici me të hyrë në pikën kufitare në Merdar. Xhudisti pejan akuzohet për “dhunë në familje” dhe për këtë veprë penale, pas intervistimit, me urdhër të prokurorit është dërguar në mbajtje për 48 orë. “Pejë 13.04.2024, 13:30. Lidhur me rastin është arrestuar i dyshuari mashkull kosovar dhe i njëjti, pas intervistimit, me vendim të prokurorit, është dërguar në mbajtje”, njofton Policia e Kosovës. Xhudisti nga Peja është i ngarkuar me veprën penale “Dhunë në familje”. Ai dyshohet se ka ushtruar dhunë fizike ndaj gruas së tij.

Lanika Rexhepi mposht garuesen serbe, fiton medaljen e artë në Shkup

Lanika Rexhepi nga klubi i karatesë “Olimp” ka shkëlqyer në turneun ndërkombëtar “Olimp Open” në Shkup. Ajo fitoi medaljen e artë në kategorinë e kadeteve +54 kg, e ku në gjysmëfinale e mposhti garuesen e Serbisë. Krahas Lanikës me medalje u stolis edhe Danina Rexhepi. Ajo fitoi medaljen e argjendtë në kategorinë deri 49 kg si dhe medaljen e bronzitë në kategorinë +45 kg. Ndërkaq Stina Dauti, përkundër paraqitjes së mirë, nuk arriti të plasohet në serinë për medalje.

Punimet në stadiumin e Malishevës drejt përfundimit

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka bërë me dije se punimet në stadiumin e Malishevës janë drejt përfundimit. Çeku në llogarinë e vet në “Facebook” thekson se do të vazhdojnë të investojnë për përmirësimin e infrastrukturës sportive në gjithë vendin. “Vazhdojmë pa u ndalur të investojmë për zhvillimin e infrastrukturës sportive në gjithë vendin. Po krijojmë kushte më të mira për sportistët dhe sportdashësit”, ka shkruar Çeku. Përndryshe, Çeku së fundmi njoftoi që Suhareka dhe Rahoveci do të bëhen me stadione të reja.

Sonte mësohet gjysmëfinalisti i fundit i ‘play-off-it’ në basketboll

PRISHTINË, 17 PRILL - Sonte (e enjte) do të përcaktohet gjysmëfinalisti i fundit i “play-off-it” në Superligën e Kosovës në Basketboll. Sigal Prishtina dhe Vëllaznimiti do të luajnë ndaj njëri-tjetrit në kryeqytet. Rezultati i kësaj serie çerekfinale aktualisht është 1:1.

Cila skuadër që do të shënojë fitore kalon në gjysmëfinale. “Bardhekaltrit” e kishin fituar ndeshjen e parë me rezultat 72:64, ndërsa gjakovarët të dytën 66:65. Përballja në mes të Sigal Prishtinës dhe Vëllaznimiti zhvillohet të enjten nga ora 20:00. Fituesi i këtij

takimi në gjysmëfinale takohet me Trepçën, e cila ishte e para në stinorin e rregullt dhe starton në gjysmëfinale. Ndeshja e parë është në fundjavë në Mitrovicë. Në gjysmëfinalen tjetër përballen Peja dhe Golden Eagle Ylli të shtunën në “Karagaçi”.



Në Athinë ndizet pishtari me flakën olimpike

ATHINË, 17 PRILL - Të mërkurën paradite, në Olimp të Athinës, është ndezur pishtari me flakën olimpikë që do të udhëtojë deri në Francë, ku këtë verë do të zhvillohen Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Ndezja e flakës olimpikë dhe qëndrimi i saj në Greqi për disa ditë është vetëm

faza e parë e një udhëtimi të gjatë. Ceremonia e u mbajt në prani të presidentes së Republikës së Greqisë, Katerina Sakellaropoulou; kryetares së Bashkisë së Parisit, Anne Hidalgo; sekretares franceze të shtetit për frankofoninë dhe partneritetet ndërkombëtare, Chrysoula

Zacharopoulos dhe presidentit të Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach. Aktorja Mary Mina ndezi flakën para rreth 600 të ftuarve, ndërsa himni olimpik u interpretua nga mexosopranoja Joyce Di Donato. Sipas një teknike të lashtë, flaka mer jetë falë rrezeve të diellit të

cilat reflektohen në një pasqyrë cilindrike parabolike, duke lëshuar nxehtësi të fortë e cila ndez flakën. Sportisti i parë grek që do ta mbajë pishtarin lart do të jetë Stefanos Ntouskos, kampion olimpik i kanotazhit në Tokio 2020. Më pas, ai do t'ia pasojë flakën olimpikë notares



franceze Laure Manaudou, e cila fitoi titullin e saj të parë olimpik në 400 m stil i lirë në Lojërat Olimpikë "Athinë 2004".

Ramadani: Dua mbijetesën me Leccen, pastaj Evropianin me Shqipërinë

LECCO, 17 PRILL - Mesfushori i Lecces dhe i Kombëtares shqiptare, Ylber Ramadani, foli në një konferencë për shtyp para ndeshjes ndaj Sassuolos. "Në çdo ndeshje ne përpiqemi ta mbrojmë portën. Të mos pësosh gol është shumë mirë. Le të fillojmë me këtë mentalitet. Nuk kemi arritur ende sigurinë, ka ende pikë për të marrë. Ne fituam një betejë të drejtpërdrejtë, por duhet të luftojmë. Seria A është e vështirë. Do të jetë thelbësore të marrim sa më shumë pikë në këto gjashtë ndeshje", ka thënë Ramadani.

I pyetur për ndikimin e trajnerit Luca Gotti në paraqitjen e skuadrës, mesfushori nga Ferizaj u përgjigj: "Trajneri ndryshon formacionin nga ndeshja në ndeshje. Tani luajmë me dy në mesfushë. Jemi më kompakt. Kjo është një rrugë më e mirë për t'u ndjekur dhe nuk pësojmë gol në tri ndeshjet e fundit. Tani jemi të përqendruar te ndeshja



e radhës që është Sassuolo". "Euro 2024? Kur hyj në fushë kam besim të madh. Nuk kam frikë nga askush. Thjesht dua të bëj mirë dhe ta fitoj ndeshjen. Dua të arrij fillimisht mbijetesën me Leccen dhe më pas të bëj mirë në Kampionatin Evropian me Shqipërinë", ka deklaruar futbollisti shqiptar.

Ish-lojtari i Ferizajt foli edhe për lidhjen e fortë që ka me tifozët. "Dua t'i përshëndes të gjithë tifozët në fund të ndeshjes, sepse ata paguajnë para për të ardhur dhe për të brohoritur. Unë doja t'i falënderoja të gjithë. Falë tyre ne fituam ndeshjen", ka shtuar Ramadani.

Lakersat kualifikohen në 'play-off', eliminohet Golden State

NEW ORLEANS, 17 PRILL - Janë luajtur dy ndeshjet e para të fazës "play-in", të dyja në Konferencën e perëndimit. Ekipi i lakersave fitoi me rezultat 110-106 ndaj New Orleansit jashtë fushe, duke u kualifikuar në fazën "play-off". Miqtë përsëritën rezultatit e pak ditëve më parë, ku sërish patën fituar. Një ndeshje me rivalitet dhe emocione deri në fund, ku të dyja skuadrat dueluan për fitore. Të gjithë titullarët e lakersave realizuan mbi 13 pikë, ku u dallua Le Bron Jamesi me 23 pikë, Russell me 21 e Davisi me 20 pikë. Në çerekfinale, lakersat do të luajnë ndaj



kampionëve të Denverit. Në ndeshjen tjetër, Sacramento mundi 118-94 Golden Staten, duke eliminuar këtë të fundit. Sfidë e komanduar nga Kingsi, ku u dallua Keegan Murray me

32 pikë, ndërsa 22 pikët e Curryt mbetën për statistikë. Sacramento dhe New Orleansit do të luajnë ndeshje shtesë për ta përcaktuar ekipin e tetë çerekfinalist në Perëndim.

KONFERENCA E PERËNDIMIT, "PLAY-IN"

New Orleans - Lakers 106-110
Sacramento - Golden State 118-94
18/04, New Orleans - Sacramento

Konferenca e Lindjes, "play-in"
Philadelphia - Miami
Chicago - Atlanta

Capello: Mos e krahasoni Yamalin me Messin

Lamine Yamal është padyshim një nga talentët kryesorë të Barcelonës teksa vetëm në moshën 16-vjeçare është shndërruar në një nga lojtarët më të rëndësishëm për

trajnerin Xavi Hernandez. Ish-trajneri i shumë skuadrave të mëdha evropiane, Fabio Capello, i kërkon opinionit sportiv që të mos nxihet e të bëjë krahasime mes Yamalit

dhe Lionel Messin. "Yamal është një djalosh shumë i ri, ka shumë kualitet, por ju lutem mos e krahasoni me Messin. Më pëlqeu në aksionin e golit të Barcelonës ndaj PSG-së. Ai e

ndërtoi vetë aksionin. Është nga ata lojtarë që të 'djeg' në lojën një kundër një. Aty tregoi me të vërtetë shumë cilësi. Më pas loja ndryshoi prej kartonit të kuq dhe Xavi ishte i detyruar

ta zëvendësojë. Edhe pse unë mendoj se ndoshta Xavi u nxitua disi, ndoshta ishte një zëvendësim pak i shpejtë, që mund të kryhej më vonë", u shpreh Capello

SHKURT

Trajneri i Dortmundit: Tani radhën e ka PSG-ja

Borussia Dortmund bëri një mrekulli të vërtetë duke mposhtur Atletico Madridin me rezultat 4-2 në ndeshjen e kthimit dhe u kualifikua në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Pas këtij suksesi trajneri Edin Terzić është shprehur krenar me skuadrën e tij. "Jam jashtëzakonisht i lumtur, mbi të gjitha shumë krenar. Atmosfera këtu ishte e pabesueshme. Kishte dy momente gjatë ndeshjes kur ishim të eliminuar, por u treguam të fortë duke besuar deri në fund. Jam shumë krenar kur e them me bindje se e merituar kualifikimin përballë Atletico Madridit", u shpreh Terzić. "Tani do të përballemi me PSG-në. Ndeshja jonë e parë kundër saj, në grup, nuk shkoi mirë. Unë mendoj se tani ne jemi një skuadër më e mirë sesa kur u përballem me PSG-në në grupe", ka shtuar Terzić.

Simeone: Dortmundi e meritoi kualifikimin

Trajneri i Atletico Madridit, Diego Simeone, ka thënë se skuadra e Borussia Dortmundit e ka merituar kualifikimin. Sipas tij, klubi gjerman i dënoi në secilin rast që e kishte, derisa Atletico nuk ë bëri një gjë të tillë. "Futbolli i tillë është, nëse i marrim të dyja sfidat, ata bënë diçka më shumë se ne. Në ndeshjen e parë duhet të kishim bërë ndonjë gol më shumë, ndërsa ndeshjen e dytë nuk e nisëm mirë. Borussia na ndëshkoi thuasje në çdo rast që krijoi. Ne nuk e bëmë diçka të tillë. Kjo ishte diferenca e vetme, por më duhet të them se Dortmundi e meritoi kualifikimin. Jemi kualifikuar për në Botërorin e Klubeve? Nuk më intereson fare. Ky është një përfundim i mirë për klubin, jo për mua. Unë nuk jam i lumtur pas kësaj mbrëmjeje", ka deklaruar Simeone.

Xavi: U eliminua për shkak të gjyqtarit

Trajneri i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka hedhur fajin te gjyqtari për eliminimin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve nga Paris Saint-Germaini. Xavi, mes të tjerash, theksoi se ishin gabimet e gjyqtarit që e eliminuan skuadrën e tij. "Është për të ardhur keq. Rrugëtimi ynë në Ligën e Kampionëve ka përfunduar për shkak të gabimit të gjyqtarit. Sapo i thashë gjyqtarit se ai ishte një fatkeqësi. Është realiteti", u shpreh Xavi. Përndryshe, PSG-ja e eliminoi Barcelonën në mbrëmje nga kjo garë me rezultat 6-4, nga dy ndeshjet.

Enrique: Do të kishim fituar edhe pa kartonin e kuq të Araujos

Paris Saint Germaini ka bërë përmbyse ndaj Barcelonës duke fituar ndeshjen e kthimit 1-4 dhe duke kaluar në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve. Trajneri Luis Enrique e ka pranuar se ka qenë shumë e vështirë për të luajtur ndaj Barcelonës, klub ku ka luajtur dhe ka qenë edhe trajner. "Ka qenë e vështirë të luash kundër Barçës nga një nivel sentimental. Shpresoj të mos luaj më shumë kundër Barçës", ka thënë Enrique, i cili shtoi se shpreson ta shohë Xavin gjatë te Barça. "Xavi ka bërë punë të madhe dhe shpresoj ta shoh gjatë te Barcelona", vazhdoi tutje trajneri spanjoll. "E dinim se do të ishte një lojë me gola dhe ishim të përgatitur për të gjithë skenarët. Ata filluan të humbin para se të luhej një çerek ore". I pyetur më pas nëse kartoni i kuq ndaj Araujos e kishte kushtëzuar Barçën dhe ndeshjen, Luis Enrique tha se do të fitonin edhe me Araujon në fushë. "Nuk e kam parë atë rast, por zakonisht nuk i gjykoj gjyqtarët. Përrjashtimi është padyshim një faktor i rëndësishëm, por rezultati është i drejtë. Do të fitonim këtë sfidë edhe nëse nuk do të ishte kartoni i kuq për Araujon", përfundoi tekniku spanjoll.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 39 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 401 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit ri shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

- 1. Pozita:** Përkthyes – nga gjuha shqipe në gjuhë serbe anasjelltas;
Numri i referencës: RPSA/ZKA/04-06/24
Grada: ZKA-C6
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ndihmon Udhëheqësin e divizionit në përcaktimin e objektivave dhe hartimin e planeve të punës;
- Bën përkthimin e dokumenteve nga gjuha shqipe në gjuhë serbe dhe anasjelltas sipas normativit të përcaktuar për një ditë pune. Normativi mesatar për përkthim të dokumenteve brenda një ditë pune përfshinë mesatarisht 2000 fjalë.
- Bën përkthimin simultan në takime pune, punëtori, konferenca, trajnime dhe në raste të tjera sipas nevojave të ZKA-së;
- Ndihmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyer si dhe saktësinë e tyre me kuptim të qartë dhe sipas normave gramatikore dhe të sintaksës;
- Mban bazën e të dhënave dhe informacioneve lidhur me përkthimet e bëra të të gjitha dokumenteve.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale prej tyre një (1) vit dëshmi në fushën e përkthimit.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e përkthimeve;
- Njohuri në terminologjinë e fushës së auditimit, kontabilitetit dhe financave;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **03.05.2024 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U sklado sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, kao i člana 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (izmenjen i dopunjen Pravilnikom (NKR) br. 01/2023); vezano sa članom 39 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2024. godinu, kao i Odluke Generalne Revizorke Br. 401 za popunjavanje slobodnog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije ponovo objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

- 1. Položaj:** Prevodilac - sa albanskog na srpski i obrnuto;
Broj reference: RPSA/ZKA/04-06/24
Nivo: ZKA-C6
Broj radnih mesta: Jedno (1)
Trajanje imenovanja: Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pomaže vodi odeljenja u postavljanju ciljeva i izradi planova rada;
- Vrši prevod dokumenata sa albanskog na srpski i obrnuto prema normi utvrđenoj za radni dan. Prosečna norma za prevodenje dokumenata u toku radnog dana obuhvata u proseku 2000 reči.
- Vrši simultano prevodenje na radnim sastancima, radionicama, konferencijama, obukama i u drugim slučajevima prema potrebama NKR-a;
- Pomaže u definisanju i usaglašavanju terminologije, za prevedene dokumente i dokumente, kao i njihovu tačnost sa jasnim značenjem i u skladu sa normama gramatike i sintakse;
- Održava bazu podataka i informacije u vezi sa prevodom svih dokumenata.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva od kojih jedna (1) godina dokaz u oblasti prevodenja.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u oblasti prevoda;
- Poznavanje terminologije revizije, računovodstva i finansija;
- Veština u komunikaciji i planiranju rada;
- Sposobnost izvršavanja zadataka i poslova pod pritiskom;
- Računarske veštine programskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za konkurisanje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovana;
- dokazi o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnom odlukom (ne starija od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na sajtu Nacionalne Kancelarije Revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je **03.05.2024 do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručnju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Caffe Bar Arioni" SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812067173 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Caffe Bar Arioni" D.O.O. Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812067173 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Caffe Bar Arioni" L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812067173 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpeite

RESTAURANT

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ambulanca Neuropsikiatrike "Mens Sana" shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 70933225.

- Trim Ademi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811928481, parku lounge sh.p.k.

- Qerime Kelmendi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Jeton Korllari shpall te pavlefshme 2 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.

- Razije Cocaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.

- Jeton Korllari shpall te pavlefshme 2 dëftesat shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Ramiz Shala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Akademis Pedagogjike "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu-ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

